

# TERAPIA RADIOMETABOLIKE AMBULATORIALE ME JOD-131

## Informacione të përgjithshme

### Treguesi i lëndës

Çfarë është dhe pse bëhet terapia radiometabolike ambulatoriale me Jod-131?

Në çfarë konsiston terapia radiometabolike me Jod-131?

A shkakton kjo terapi efekte anësore ose a mund të më krijojë ndonjë problem?

Ku duhet të paraqitem ditën e terapisë?

Si duhet të përgatitem ditën e terapisë?

Çfarë duhet të marr me vete ditën e terapisë?

Kush punon në Mjekësinë Nukleare?

Çfarë ndodh ditën e terapisë?

Si duhet të silllem pasi të kem marrë kapsulën me Jod-131?

A ka gjëra të tjera që duhet të di për të mbrojtur sigurinë time dhe atë

të personave të tjerë?

Si do të vazhdojë ecuria ime e kurave pas terapisë radiometabolike me Jod-131?

Kontakte

E/i nderuar Znj. / Z. \_\_\_\_\_,

kjo broshurë është realizuar për t'ju dhënë disa informacione të dobishme mbi terapinë radiometabolike me Jod-131 për kurimin e disa çrregullimeve të tiroides. Kjo terapi bëhet në regjim ambulatorial (jo me shtrim në spital). Kjo do të thotë se ne do t'ju japim një kapsulë Jod-131 dhe ju mund të ktheheni në shtëpi.

Në këtë broshurë mund të gjeni informacione në lidhje me:

- çfarë është terapia radiometabolike ambulatoriale me Jod-131;
- për çfarë shërben kjo terapi;
- çfarë duhet të bëni përpara, gjatë dhe pas terapisë.

Të dhënat që gjenden në këtë broshurë nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë takimin direkt që keni me profesionistët sanitarë. Përdoreni këtë broshurë si një sugjerim të pyetjeve dhe kërkesave.

Ju duhet të paraqiteni për terapi me datë \_\_\_\_\_ në orën \_\_\_\_\_ pranë Mjekësisë Nukleare.

## Çfarë është dhe pse bëhet terapia radiometabolike ambulatoriale me Jod-131?

Terapia radiometabolike është një lloj i veçantë i terapisë që përfshin përdorimin e Jodit radioaktiv, Jod-131 (ose 131J). Me terapinë radiometabolike është e mundur të kurohen disa çrregullime të tiroides, si Sëmundja Basedow/Graves, Struma Nodulare dhe Adenoma Toksike.

Këto sëmundje krijojnë disa probleme në funksionimin e tiroides.

Qëllimi i kësaj terapie është që t'i japë mundësi tiroides që të rifillojë funksionimin e saj normal.

## Në çfarë konsiston terapia radiometabolike me Jod-131?

Terapia konsiston thjeshtë në marrjen e vetëm të një 1 kapsule me Jod-131. Kapsula Jod-131 është një kapsulë normale, krejtësisht e ngjashme me hape normale ose tableta. Jodi-131 është një substancë radioaktive. Për këtë arsye, pas terapisë ju duhet të ndiqni disa udhëzime për mbrojtjen e sigurinë tuaj dhe të personave që u qëndrojnë afër. Këto udhëzime gjenden në seksionin "Çfarë duhet të bëj pasi të kem marrë kapsulën e Jodit-131?" në f. 6.

## A shkakton kjo terapi efekte anësore ose a mund të më krijojë ndonjë problem?

Zakonisht kjo terapi **nuk** jep shqetësime, sepse përbëhet nga doza të vogla Jodi-131.

Kjo terapi, megjithatë, **nuk** mund të përdoret kur jemi duke ushqyer me qumësht dhe **nuk mund** të bëhet kur jemi shtatzënë.

Nëse jeni duke ushqyer me gji, pasi të keni marrë kapsulën e Jodit-131 duhet të ndërpritni menjëherë dhe përgjithmonë të ushqyerit me gji.

Përpara se të filloni një shtatzëni të re është e nevojshme që të kaloni një interval kohe i përshtatshëm. Ne rekomandojmë që të prisni të paktën 1 vit pas terapisë. Ky udhëzim vlen si për gratë ashtu edhe për burrat.

## Ku duhet të paraqitem ditën e terapisë?

Ditën e terapisë suaj duhet të paraqiteni te Mjekësia Nukleare.

Nga kati i parë (kati i barit) ndiqni rrugën e grupit të ngjitjes n. 2. Mjekësia Nukleare gjendet në katin 1.

## Si duhet të përgatitem ditën e terapisë?

Ditën e terapisë ju duhet të paraqiteni **pa ngrënë (as ushqime e as lëngje) duke filluar nga mesnata e mëparshme.**

Ju duhet të merrni gjithashtu terapinë tuaj eventuale të zakonshme (*p.sh. ilaçet për zemrën, ilaçet për kontrollin e tensionit etj*). Në këtë rast, ju mund t'i merrni këto ilaçe me një gllënjë të vogël uji.

## Çfarë duhet të marr me vete ditën e terapisë?

Mos harroni të merrni me vete:

- taserën sanitare të letrës;
- kodin fiskal;
- një dokument identiteti;
- kërkesat e bëra nga mjeku endokrinolog për:
  - soministrimi i terapisë radiometabolike;
  - analizat e gjakut për të përcaktuar vlerën e hormonit të tiroides FT3;
  - Testin e shtatzënisë të bërë në urinë (për pacientet gra në moshë riprodhuese). Ky test është i nevojshëm për shkak se nuk mund të bëhet terapia radiometabolike gjatë shtatzënisë.

## Kush punon në Mjekësinë Nukleare?

Te Mjekësia Nukleare ju do të takoheni me profesionistë të ndryshëm që punojnë në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin:

**Infermierët:** janë profesionistët që merren me të gjitha aspektet e asistencës dhe të edukimit sanitar.

**Mjekët Nuklearë:** vizitojnë pacientët përpara se të soministrojnë terapinë; përshkruajnë terapitë e tjera të mundshme sipas nevojës.

**Teknikë Sanitarë të Radiologjisë Mjekësore (TSRM):** punojnë së bashku me mjekun nuklear për t'i soministruar pacientëve kapsulën e Jodit-131.

## Çfarë ndodh ditën e terapisë?

Së pari, ju duhet të paraqiteni te sporteli i pranimit (*sekretaria jonë*). Personeli i pranimit do të regjistrojë ardhjen tuaj, do t'ju ftojë të prisni në sallën e pritjes dhe do të lajmërojë një infermiere për ardhjen tuaj. Në këtë kohë një infermier/e do t'ju bëjë një marrje gjaku për të përcaktuar vlerën e hormonit të tiroides FT3. Vetëm në qoftë se jeni grua në moshë riprodhuese, duhet të bëni një test shtatzënie nëpërmjet urinës. Për të bërë terapinë, testi duhet të rezultojë negativ. Ju mund të bëni një vizitë me mjekun nuklear. Gjatë kësaj vizite mjeku:

- do t'ju pyesë se sa kohë jeni pa ngrënë;
- do t'ju pyesë se sa kohë ka që keni pezulluar marrjen e ilaçit antitiroide (për shembull Tapazole®), në bazë të udhëzimeve që ju ka dhënë endokrinologu juaj;
- do t'i përgjigjet pyetjeve dhe dyshimeve tuaja të mundshme.

Në këtë pikë, tekniku sanitar i radiologjisë mjekësore (TSRM), në praninë e mjekut, do t'ju ftojë të merrni kapsulën e Jodit-131. Pasi të merrni kapsulën, mjeku do t'ju dorëzojë relacionin ku paraqitet terapia që ju është dhënë. Në këtë pikë ju mund të ktheheni në shtëpi. Nëse do të keni nevojë për një certifikatë justifikimi (p.sh. për të marrë leje në punë), mund ta kërkonte te sporteli i pritjes (sekretaria).

## Si duhet të sillem pasi të kem marrë kapsulën me Jod-131?

Pasi të keni marrë kapsulën e Jodit-131, ju duhet të qëndroni pa ngrënë për 2 orë të tjera. Kjo shërben që të jetë i sigurt absorbimi i plotë i Jodit-131 nga organizmi juaj. Pas këtyre 2 orësh, ju mund të hani diçka pasdreke (zamër). Kjo do të thotë që ju mund të hani vetëm një sasi të vogël ushqimi, jo një vakt të plotë. Ju mund të hani një vakt të plotë vetëm atëherë kur të kenë kaluar të paktën 6 orë nga terapia.

Për 3-4 orë pas këtij ushqimi të lehtë, ju këshillojmë që të pini dhe të hani sa më pak të jetë e mundur.

Pas terapisë, ju mund ta ndërpritni dietën e varfër me jod të cilën e keni filluar tash rreth 4 javë.

Siç është shkruar më parë, përveç kësaj, Jodi-131 është një substancë radioaktive e cila eliminohet nëpërmjet pështymës, djersës, urinës dhe jashtëqitjes. Niveli i radioaktivitetit pas kësaj lloj terapie do të jetë, megjithatë, në një nivel të tillë sa që të mos sjellë rreziqe të konsiderueshme rrezatimi. Për këtë arsye, ashtu siç kërkohet nga normativa evropiane për mbrojtjen nga radiorrezatimi, pas

marrjes së terapisë ju mund të ktheheni në shtëpi. Megjithatë, për të zvogëluar rrezatimin dhe kontaminimin dhe për të eliminuar më shpejt radioaktivitetin, **ndiqni udhëzimet e shkruara këtu më poshtë, edhe për të respektuar personat që qëndrojnë rreth jush.**

**Ju këshillojmë që të ndiqni këto udhëzime për të paktën 15 ditë.** Duhet të keni parasysh se, pas 15 ditësh pasi të keni marrë terapinë, të gjitha objektet dhe ambientet me të cilat keni pasur kontakt nuk do të jenë më radioaktiv. Në fakt, radioaktiviteti i Jodit-131 e humbet fuqinë gradualisht pa lënë asnjë mbetje.

Çfarë duhet bërë	Çfarë duhet bërë për të mbrojtur sigurinë e personave të tjerë
<b>Pini shumë lëngje (të paktën 1 litër e gjysmë në ditë)</b>	<b>Përdorni enë (pjata, gota, servis), peceta dhe shami njëpërdorimshme (që përdoren vetëm një herë).</b>
<b>Lani duart shpesh.</b>	<b>Lani sendet personale veç, rrobat dhe ndërresat (mbathje, të brendshme etj) që keni përdorur gjatë 15 ditëve pas terapisë. Jodi është një element shumë i tretshëm dhe hiqet krejtësisht, pas një larjeje me ujë.</b>
<b>Mundohuni që të urinoni shpesh.</b>	<b>Nëse përdorni një banjë të përbashkët me njerëz të tjerë, hidhni ujin e WC-së të paktën dy herë. Në qoftë se përdorni dushin dhe/ose vaskën së bashku me persona të tjerë, shpëllajini vetëm me ujë të paktën dy minuta pasi t'i keni përdorur ato.</b>
<b>Mundohuni që të kryeni jashtëqitjen të paktën një herë në ditë.</b>	<b>Mund të dilni nga banesa juaj, por përpiquni që të mos qëndroni për një kohë të gjatë në vende të mbushura me njerëz.</b>
	<b>Kufizoni në minimum kontaktin me personat në moshë riprodhuese (në veçanti me fëmijët dhe gratë shtatzëna).</b>
	<b>Shmangni fjetjen me partnerin tuaj dhe shmangni marrëdhëniet seksuale.</b>
	<b>Shmangni frekuentimin e vendit të punës, veçanërisht në qoftë se kjo gjë ju detyron të qëndroni në kontakt të ngushtë me njerëz të tjerë.</b>

**Kujdes:** siç u tha më sipër, radioaktiviteti eliminohet edhe nëpërmjet urinës dhe jashtëqitjes. Për këtë arsye, ju duhet të keni një vëmendje të veçantë për të gjitha materialet që do të bien në kontakt me urinën dhe jashtëqitjen tuaj. Për disa nga këto materiale, si për shembull mbathje apo veshje të tjera intime, është e mjaftueshme që t'i lani ato veç e veç.

Megjithatë, duhen mbajtur në bodrum ose garazh në qese të mbyllura **për të paktën 7 ditë** të gjithë materialet që duhen eliminuar ose që nuk mund të lahen (për shembull, panolinat e ndotur). Kjo shërben për të mbrojtur ambientin. Pas këtyre 7 ditëve, ju mund t'i hidhni këto qese në kontejnerët për grumbullimin e hedhurinave të parikuperueshme.

## A ka gjëra të tjera që duhet të di për të mbrojtur sigurinë time dhe atë të personave të tjerë?

Sipas linjave udhëzuese evropiane dhe në bashkëpunim me Fizikën Mjekësore është identifikuar në 3 metra largësia përtej së cilës rreziku i rrezatimit është i kufizuar (*i ulët*). Megjithatë, edhe koha e mundshme e kontaktit është një faktor që duhet të merret parasysh: sa më pak kohë që i qëndrojmë afër një personi radioaktiv aq më pak rrezatime merren.

Në rastin e udhëtimeve ajrore në ditët pas terapisë, prania e detektorëve të radioaktivitetit në aeroporte mund të krijojë situata të pakëndshme dhe të kërkojë kontrolle shtesë. Sipas gjykimit të autoriteteve të aeroportit ka mundësi që të ndalohet hyrja në bordin e avionit. Ju këshillojmë, pra, që t'i kërkonit mjekut nuklear certifikatën për përdorimin e terapisë dhe ta merrni me vete.

## Si do të vazhdojë ecuria ime e kurave pas terapisë radiometabolike me Jod-131?

Do të jetë endokrinologu juaj ai që do të planifikojë mënyrën se si do të vazhdojë rrugëtimi i kurës suaj.

Infermieri me të cilin kam folur sot quhet:

---

Orietta Bovolenta

---

Claudia Buffagni

---

Antonio Capizzi

---

Maria Marsico

---

Valeria Merli

---

Donata Veroni

## Tekstet dhe përmbajtjet nën kujdesin e

Personeli infermieristik Terapia Radiometabolike

Angelina Filice, *Mjek Nuklear, Përgjegjës i Seksionit të Terapisë Radiometabolike*

Federica Fioroni, *Fizikan, Fizika Mjekësore*

IRCCS - Arcispedale Santa Maria Nuova - Reggio Emilia

## Rishikimi lingualistik dhe tekstual:

Elena Cervi, infermiere, Biblioteka për Pacientët – Pika Informative për pacientët dhe familjarët, Biblioteka Mjekësore Inter-firmat

Simone Cocchi, *bibliotekar, Biblioteka për Pacientët, Biblioteka Mjekësore Inter-firmat*

IRCCS - Arcispedale Santa Maria Nuova - Reggio Emilia

## Realizimi grafik

*Komunikimi, Marrëdhëniet Publike, Informacioni*

# Mjekësia Nukleare

*Drejtor: Dr. Annibale Versari*

*Koordinimi i Infermierisë: Carmen Prandi*

*Koordinues Teknik: Simona Cola*

Terapia Radiometabolike

tel. 0522 296468

nga e hëna deri të premten, preferohet pasdreke (nga ora 12 deri në orën 19)

Faks:

Mjekësia Nukleare 0522 296153

Terapia Radiometabolike 0522 296458

*Botimi i parë: Dhjetor 2014*